REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 324, Datë 03.11.2026

MBI

REGJISTRIMIN E IMPIANTIT TË DEPOZITIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË "SPV BLUE 2" SH.P.K.

Në mbështetje të neneve neneve 16 dhe 51 të ligjit nr. 59/2026 *"Për sektorin e energjisë elektrike"*; nenit 6 të *Rregullave për regjistrimin në ERE të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 230, datë 18.08.2026; si dhe nenit 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 03.11.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2372/4 prot., datë 03.11.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës *"Mbi kërkesën e shoqërisë "SPV Blue 2" sh.p.k. për regjistrimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike",*

Konstatoi se:

- Shoqëria "SPV Blue 2" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 603, Seria P24, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 296, datë 30.12.2024, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku fotovoltaik "Blue 2", me kapacitet të instaluar 100 MW, si dhe e licencës së tregtimit të energjisë elektrike nr. 626, seria T25, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 154, datë 17.07.2025.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2372 prot., datë 31.07.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për regjistrimin e impiantit të energjisë elektrike referuar licencës së prodhimit të energjisë elektrike.
- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2372/1 prot., datë 09.09.2026, shoqëria ka kërkuar regjistrimin e një impianti depozitimi me kapacitet 400 MW/1600 MWh, referuar licencës së tregtimit të energjisë elektrike dhe në mbështetje të Rregullave të miratuara me vendimin e bordit të ERE-s nr. 230/2026.
- Për sa më sipër, ERE, me shkresën nr. 2372/2 prot., datë 14.10.2026, i kërkoi shoqërisë të saktësonte licencën së cilës i referohej kërkesa për regjistrim, si dhe të qartësonte nëse impianti i depozitimit për të cilin kërkohej regjistrimi ishte i njëjti me atë të përfshirë në aplikimin për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike nr. 603, seria P24, procedurë e pezulluar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 276, datë 25.09.2026.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2372/3 prot., datë 20.10.2026, shoqëria sqaroi se kërkesa e parë lidhet me impiantin 300 MW/802.5 MWh referuar licencës së prodhimit, ndërsa kërkesa e dytë lidhet me një kapacitet shtesë prej 400 MW/1600 MWh, dhe se referimi ndaj licencës së tregtimit, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. nr. 154, datë 17.07.2025 është bërë për të pasqyruar funksionin e këtij kapaciteti në planifikimin e shitjeve dhe zhvendosjen në kohë të livrimit të energjisë së Parkut Fotovoltaik "Blue 2".

- Po ashtu, shoqëria sqaron se konfigurimi i synuar përbëhet nga dy komponentë: 300 MW/802.5 MWh, të lidhur me licencën e prodhimit, dhe 400 MW/1600 MWh, të lidhur me licencën e tregtimit, pa mbivendosje ose numërim të dyfishtë. Gjithashtu, shoqëria deklaroi se do të ndjekë procedurat përkatëse të autorizimit, lidhjes me rrjetin dhe licencimit të operimit të depozitimit
- Për sa më sipër, sqarojmë se me vendimin e bordit të ERE-s nr. 310, datë 26.10.2026, është miratuar, ndër të tjera, njohja dhe lejimi i operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike me kapacitet 300 MW/802.5 MWh, ndaj më poshtë paraqesim analizën përkatëse për impiantin me kapacitet 400 MW/1600 MWh, referuar licencës së tregtimit të energjisë elektrike.
- Rezulton se kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar në nenin 51 të ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike*" dhe të *Rregullave për regjistrimin në ERE të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 230/2026 dhe shoqëria "SPV Blue 2" sh.p.k. ka paraqitur formularin e plotësuar, dokumentacionin teknik dhe atë financiar.
- Për sa më sipër, vlerësohet se plotësohen kushtet për vijimin e procedurës së regjistrimit të impiantit të depozitimit të energjise elektrike "Blue", me fuqi nominale ngarkimi 100 MW, fuqi nominale shkarkimi 400 MW, dhe kapacitet energjetik depozitimi 1600 MWh, në kuadër të licencës së shoqërisë "SPV Blue 2" sh.p.k. për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Sipas të dhënave të deklaruara në Formularin e Regjistrimit, procedura për lidhjen e impiantit është ende në proces, si e tillë shoqëria duhet të pajiset me miratimin/marrëveshjen për pikën e lidhjes.
- Shoqëria ka detyrimin që gjatë operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike (BESS) të respektojë kufirin e fuqisë aktive totale të injektuar në pikën e lidhjes me rrjetin, si dhe kushtet dhe kufizimet teknike të përcaktuara nga operatori i rrjetit dhe çdo detyrim tjetër që buron nga legjislacioni në fuqi.
- Shoqëria mund të operojë sipas përcaktimeve të kësaj dispozite për një periudhë jo më shumë se 12 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit (pra për periudhën e mbetur). Për vijimin e ushtrimit të kësaj veprimtarie përtej këtij afati, shoqëria duhet të paraqesë pranë ERE-s aplikimin për pajisjen me licencën përkatëse, në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi.
- Për këtë vendimmarrje vlerësohet që të njoftohet dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe shoqëria "Operatori i Sisteit të Transmetimit" (OST) sh.a.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të regjistrojë impiantin e depozitimit të energjisë elektrike, të deklaruar nga shoqëria "SPV Blue 2" sh.p.k., me fuqi nominale ngarkimi 100 MW, fuqi nominale shkarkimi 400 MW dhe kapacitet energjetik depozitimi 1600 MWh, në kuadër të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Impianti i depozitimit të energjisë elektrike (BESS), i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, njihet dhe lejohet të vijojë operimin, për periudhën kalimtare të përcaktuar në nenin 51, pika 3, të ligjit nr. 59/2026 "Për sektorin e energjisë elektrike".
3. Për operimin e impiantit të depozitimit pas datës 14.07.2027, shoqëria duhet të aplikojë për licencën përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

4. Çdo ndryshim në të dhënat e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike duhet të njoftohet nga shoqëria në ERE.
5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të marrë masat për regjistrimin dhe pasqyrimin e të dhënave të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike në Regjistrin përkatës të ERE-s, dhe në Fletën individuale të regjistrimit, në përputhje me rregullat në fuqi, përfshirë cdo ndryshim të këtyre të dhënave të njoftuar nga shoqëria sipas pikës 4 të këtij vendimi.
6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë "SPV Blue 2" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe shoqërinë "Operatori i Sisteit të Transmetimit" sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI